

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11)), sidhe n; bazë të nenit 50 alinea 6 nga Ligji për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së veriore “ nr.161/2019)Ministri për arsim dhe shkencë e solli programin e shkurtuar nga lënda e Arsimit Muzikor të klasës së I të arsimit fillor nëntëvjeçarë të vitit shkollor 2020/21.



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Byroja e zhvillimit të arsimit

PROGRAMI I SHKURTUAR  
MËSIMOR

# ARSIMI MUZIKOR

SHTATOR 2020

KLASA I

Arsimi fillor nëntëvjeçar

## 1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore **Arsimi Muzikor** bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parashikuara me programin e rregullt mësimor për këtë lëndë të paraparë me planin mësimorë.

Në programin e shkurtuar janë përcaktuar tema dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen gjatë 159 ditëve mësimore, kU duke pasur parasysh fondi javor I orëve 2 orë mësimore, i përcaktuar në programin e rregullt mësimor., gjegjësisht 64 gjithsejt.

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda Arsimi muzikor për klasën e parë të arsimit fillor nëntëvjeçar realizohet në vitin shkollor 2020/21

### 1. Pasqyrë e temave dhe njësive mësimore

TEMA: AKTIVITETET EKZEKUTUESE (30 ORË)
--

<b>Njësitë mësimore:</b>
--------------------------

- |  |
|--|
| <ol style="list-style-type: none"><li>1. Hulumtim – fëshfërimat,tingujt dhe zërat nga mjedisi natyror</li><li>2. Imitimi i fëshfërimave, tingujve,zërave nga mjedisi natyror.</li><li>3. Dëgjojmë tinguj nga natyra (zogjët, kafshët)</li><li>4. Krijojmë tinguj.</li><li>5. Ushtrime për frymëmarrje të rregull.</li><li>6. Loja „Fryejmë balonat“</li><li>7. Lojë me gjësendet e imagjinuara.</li><li>8. Ushtrime për mbajtjen e drejtë të trupit gjatë këndimit.</li><li>9. Këndim i motiveve - ushtrime për këndim të drejtë, mbajtje të drejtë të trupit, ushtrime për frymëmarrje.</li><li>10. Këndim i këngëve për shkollën ose familjen.</li></ol> |
|--|

11. Këndim i këngëve për natyrën dhe mjedisin jëtësor.
12. Këndim i këngëve për stinët e vitit.
13. Këndim i këngëve popullore.
14. Përpunim i këngës me të dëgjuar.Обработка на песна по слух
15. Shqiptimi i numërakeve me ritëm të caktuar.
16. Shqiptimi i fjalëshpejtave me dikcion të qartë.
17. Përpunim i shkopinjëve për rënie dhe prodhim të tingujve nga materiali natyror.
18. Ekzekutim I motiveve ritmike me rënje të shkopinjëve
19. Rrahje e duarve, përplasje me këmbë dhe shqiptimi i numërakeve veç më të mësuara dhe këngëve për fëmijë për të mbajtur ritmin.
20. Ekzekutim i motiveve ritmike hapërimi- kombinimi i hapave dhe kërcimit.
21. Ekzekutim i „Nëse ti je i lumtur“- lojë lëvizëse
22. „Loja me topa“
23. Ekzekutim i lëvizjeve në hapësirë me ritëm sipas përzgjedhjes së
24. Ekzekutim i valles popullore „Shota,,
25. Lojë muzikor dhe dramatizim („ Borëbardha dhe shtatë shkurtabiqët “)
26. Lojë muzikore („Fantasia Disney – Hippopotame et Crocodile“)
27. Lojë muzikore („ Valsi i luleve “ e baletit „ Arrëthyesja “ e Petar Iliç Çajkovskit “)
28. Lëvizje të lira dhe muzikë („Kësulkuqja“)
29. Ekzekutim i lojërave dhe dramatizim në përputhje me muzikën që dëgjojmë.
30. Ekzekutim i lëvizjeve

#### TEMA: DËGJIMI I MUZIKËS (28 ORË)

##### NJËSITË MËSIMORE:

1. Dëgjojmë fëshfërima ,tinguj ,zëra nga mjedisi jetësor.

2. Dëgjim i tingujve të këndshëm dhe jo të këndshëm nga filmat vizatimor.
3. Dëgjim dhe njohja e tingujve të këndshëm të natyrës.
4. Njohja e tingujve të natyrës , dhe njohja e tingujve të instrumenteve dhe përshkrimi i tyre.
5. Dëgjojmë instrumente muzikore dhe bisedë lidhur me karakterin e tingullit.
6. Dëgjojmë muzikë „Smfonija e fëmijëve“ prej Jozef Hajdën
7. Dëgjojmë Himnin e R. Maqedonisë së Veriut „Sot mbi Maqedoni“
8. Dëgjojmë dhe diskutim për himnin për cilat raste ekzekutohet.
9. Dëgjojmë muzikë përcaktimi i zërave të fëmijëve
10. Dëgjojmë muzikë përcaktimi i zërave të mashkullor të fëmijëve (Arien e Figaros nga opera „Berberi i Seviljes“)
11. Dëgjojmë muzikë përcaktimi i zërave të femëror të fëmijëve („kënga e kukullës“ aria Olimpija nga opera „Tregimet e Hofmanit“)
12. Dëgjojmë muzikë dhe njohja shpejtësisë/tempos (shpejt,ngadalë.): „Fluturimi i brumbullit“ nga Nikollaj Rimski Korsakov
13. Dëgjojmë muzikë dhe njohja shpejtësisë/tempos (shpejt,ngadalë.): „Elefanti“ nga Kamij Sen- Sans
14. Dëgjojmë muzikë dhe njohja fuqisë/dinamikës (e qetë, fuqishme: „Ninulla“ од J. Brams
15. Dëgjojmë muzikë dhe njohja e fuqisë/dinamikës ( e qetë e fuqishme): „Baba Dimri“ nga Robert Shumani
16. Dëgjojmë muzikë dhe njohja e toneve të larta dhe të ulta: „Elefanti“ nga Kamij Sen- Sans
17. Dëgjojmë muzikë dhe njohja e toneve të larta dhe të ulta „Kënga e zogjëve“ (fragment nga simfonija e 6-të e L.V. Bethovenit.)
18. Dëgjojmë muzikë dhe njohja e ritmit (gjatë , shkurtë): „Kenguri“ од Kamij Sen-Sans, „ Ora e Vienës“ nga Z. Kodaj.
19. Dëgjojmë muzikë dhe njohja e ritmit (gjatë ,shkurtë): „Marsh“ („Muzikë fëmijërore“) nga S. Prokofjev., Lux Aurumque – E. Whitracre
20. Dëgjojmë muzikë на „Ndriço, ndriço ylli i vogël“ од V. A. Mocart
21. Dëgjojmë fragment nga Oda e gëzimit e L.V. Bethovenit.)
22. Dëgjojmë muzikë nga Pink Panteri – Filmi vizatimor
23. Dëgjojmë muzikë nga Tomi dhe Gjeri
24. Dëgjojmë muzikë од „Piter Pan“
25. Dëgjojmë muzikë nga filmat për fëmijë
26. Dëgjojmë dhe këndojmë këngë popullore
27. Dëgjojmë dhe luajmë valle popullore
28. Bisedë rreth lidhshmërisë së muzikës me traditat dhe festat tona.

## TEMA: SHKRIM- LEXIMI MUZIKOR (6 ORË)

### Njësitë mësimore:

1. Njohja me lëvizjet e shpejta e të ngadalsuara përmes lojërave muzikore.
2. Njohja e lëvizjeve të shpejta dhe të ngadalësuara përmes simboleve grafike vizuale
3. Lartësia (lartë-poshtë,)
4. Këndojmë këngë me fuqi të ndryshme (fuqishëm dhe qetë.)
5. Lidhshmëria e toneve të larta dhe të ulëta me simbolet vizuale.
6. Njohja kohëzgjatjes së ritmit të gjatë ,shkurtër përmes gjësndeve fotove dhe simboleve të thjeshta grafike si tik taku i orës shpejtë-ngadalë;, lëvizja e kërmillit, -ngadalë; lëvizja e lepurit- shpejtë.

### 3. Rekomandimet didaktike

Pikënisja e realizimit të programit të shkurtuar nga lënda e **Arsimit Muzikor** është programi i rregullt mësimor i kësaj lënde. (qëllimet konkrete, nocionet, aktivitetete propozuara, metodat dhe mjetet mësimore)

Fëmija qysh nga mosha e hershme fëmijërore shfaq kuriozitet spontan dhe interes për botën për rreth tij, gjithashtu edhe për muzikën. Ata kanë përfituar përvoja për fëshfërimat, tingujt, zërat në rrethin e drejtëpërdrejtë ku ata jetojnë, për instrumente të ndryshme muzikore (si duken si lëshojnë tinguj), kanë dëgjuar këngë për fëmijë, ninulla, muzikë nga filmat vizatimor, emisionet për fëmijë, filmat për fëmijë etj, Njohuritë e tyre arsimtari do ti shfrytëzojë dhe do ti zgjerojë me orët nga lënda e Arsimit muzikor. Duke qenë pjesëmarrës në lojërat didaktike dhe duke përdorur materiale dhe mjete të llojllojshme, nxënësit fitojnë njohuri të reja lidhur me perceptimet auditive të tyre..

Fillojnë të vërejnë, hulumtojnë dëgjojnë, imitojnë fëshfërimat tingujt nga natyra dhe rrethi ku jetojnë e që më pas gradualisht ti dallojnë zërat e femrave dhe meshkujve duke dëgjuar muzikë vokale, vokale-instrumentale. Është posaçërisht e rëndësishme që

arsimtari të ju tregojë ushtrime për frymëmarrje të drejtë dhe qëndrim të drejtë të trupit gjatë këndimit në fillim të vitit shkollor, me çka nxënësit do ta praktikojnë edhe më vonë këtë.

Për shkak së situatës me Kovid – 19 në shtetin tonë dhe kudo në botë arsimtari do të ketë kujdes gjatë realizimit të njësive mësimore për këndim mundësisht të relizohen këndim individual dhe jo në grupe apo jashtë klasës sepse atëherë ata duhet të heqin maskat.

Gjatë realizimit të orëve mësimore nga lënda Arsimi muzikor me prezencë fizike të nxënësve është e domosdoshme të respektohen protokolet për distancë fizike dhe mbrojtje personale.

Ora mësimore do të zgjasë 30 minuta. Arsimtari do të shkurtojë pjesën hyrëse dhe përfundimtare të orës mësimore, më së paku të zgjasë 5 minuta dhe përmes teknikave të motivojë nxënësit për pjesëmarrje aktive gjatë procesit të të nxënimit dhe mësuarit.

Metodat mësimore për nxënie dhe mësim duhet të përshtaten me kohëzgjatjen e orës mësimore, duke ruajtur cilësinë në mësim Arsimtari duhet të krijojë situata për mësim ku do të vijnë në shprehje aktivitetet e ndryshme mësimore ku përdoren mjete, materiale dhe burime të ndryshme audio, audio-vizuale shfaqje, koncerte, pjesë nga opera, arie etj., Arsimtari mund të përdorë materiale edhe nga Eduino

E- përmbajtjet.

Nëse programi mësimor realizohet më mësim në largësi, arsimtari mundëson që nxënësit që janë në shtëpi në të njëjtën kohë të kyçen dhe ndjekjen e orës mësimore.

Detyrat e shtëpisë /detyrat e pavarura të nxënësve duhet të jenë të përshtatshme për moshën e tyre.

#### 4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtari klasor në përputhshmeri me Normativin për kuadër mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor nga lënda Arsimit muzikor për klasën e parë të arsimit fillor nëntëvjeçar e miratoi

MINISTËR I ARSIMIT DHE SHKENCËS

---

Mila Carovska